



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 35 26 Gusht – 2 Shtator 2019

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 35

	JAVA 35
DIARRE PA GJAK	4.383
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	5.535
INF. RESP. TE POSHTËME	2.136
RASH ME TEMPERATURË	5
VERDHEZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	1
Numri i Njësive Raportuese	392
% e Njësive Raportuese	92% (392/427)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog 3 raste si më poshtë nuk janë të dyshuar për fruth dhe rubeolë por për varicelë:

Vlorë – 2 raste

Fier – 1 rast



1 rast nga rrethi i Fierit është i dyshuar për sëmundjen: dorë-këmbë-gojë.

I dyshuar për Fruth është 1 rast nga rrethi i Lushnjes.

Ethe e pashpjegueshme



Rasti i grupmoshës 60+ vjeç është raportuar nga rrethi i Fierit. Me pas u dyshua për Brucelozë.

Diarre pa gjak




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rënie në javën 35 krahasuar me javën paraardhëse, java 34.

Infeksione respiratore




Prirja në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet e qëndrueshme në javën e 35 krahasuar me javën paraardhëse, java 34.

Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 20 – 35 të vitit 2018 dhe të vitit 2019. Numri i rasteve.




Në javën 35 të vitit 2019 vërehet prirje në rënie e numrit të rasteve të “Diarre pa gjak” dhe ky numër është 28% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 34 dhe javën 35 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)




Nga komunikimi me rrethet, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 20 – 35 të vitit 2018 dhe të vitit 2019. Numri i rasteve.




Në javën e 35 të vitit 2019 vërehet prirje e qëndrueshme e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 6% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 35 të vitit 2019. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 34 dhe 35 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)



Nivelet e Raportimit për javën e 35 sipas rretheve, në përqindje.